



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**Njoftim për shtyp**

**Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 75%+1 të aksioneve të Sigma sh.a nga shoqëria TBIH Financial Servis Group N.V(TBIH)”**

Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e tij të datës 11 shtator 2007, shqyrtoi çështjen me objekt “Njoftimi për përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes të 75%+1 të aksioneve nga Sigma sh.a te TBIH Financial Servis Group N.V (TBIH)”.

TBIH, blerësi i pjesës prej 75 % +1 të kapitalit aksionar të Sigma sh.a, është shoqëri e themeluar sipas ligjeve hollandeze me seli në Prins Hendriklaan 52, 1075 BE Amsterdam, Hollandë. TBIH është një grup shërbimesh financiare me aktivitet në fushën e sigurimeve dhe pensioneve.

SIGMA sh.a, e themeluar në dhjetor 1998 është pjesë e sistemit financiar shqiptar, e licensuar dhe mbikëqyrur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. SIGMA është kryesisht aktive në fushën e sigurimit të jo-jetës. Pjesa e tregut të shoqërisë SIGMA sh.a në tregun shqiptar të sigurimeve është 18.4 %. Sigma sh.a zotëron 100 % të aksioneve të Sigmës në Maqedoni dhe ka një degë në Kosovë. Me një numër total prej 25 degë dhe agjentë në të tre tregjet, SIGMA sh.a ka një rrjet ndërkombëtar shpërndarje në të tre vendet.

Sigma sh.a zotëron 25 % të aksioneve të Garantsig, një shoqëri administruese e fondeve të pensioneve private vullnetare. Objekti i aktivitetit të Garantsig është mbledhja e kontributeve dhe shpërndarja e përfitimeve midis personave që marrin pjesë në Fondin privat të Pensioneve në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Transaksioni i njoftuar konsiston në kontrollin e paketës prej 75. %+1 aksione të Sigma sh.a nga TBIH Financial Servis Group N.V(TBIH) dhe nuk sjell asnjë ndryshim në strukturën e përgjithshme të tregut shqiptar të sigurimeve dhe tregut të pensioneve private. Ky transaksion, përbën përfitim të kontrollit të një pjese të konsiderueshme të kapitalit aksioner dhe të së drejtës së votës dhe është një përqendrim që përmbush kushtet për të qenë subjekt i shqyrtimit nga Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 12, pika 1/a dhe b e Ligjit.

Si konkluzion, transaksioni i njoftuar i kontrollit të paketës prej 75. %+1 aksione të Sigma sh.a nga TBIH Financial Servis Group N.V(TBIH) nuk sjell asnjë ndryshim në strukturën e përgjithshme të tregut shqiptar të sigurimeve dhe tregut të pensioneve private.

Në këtë kontekst përqendrimi nuk mund të ketë efekte antikonkurruese duke qenë se në kuptimin e nenit 13, pika 1 e Ligjit, nuk rrezikon të krijojë ose të forcojë pozitën dominuese të ndërmarrjeve të përfshira në përqendrim..

Për këto arsye, në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së pjesës 75% +1 të aksioneve të shoqërisë Sigma sh.a nga TBIH Financial Servis Group N.V(TBIH).